



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Adresa Rr. Zija Shemsiu pn, 60000 Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Vendim.nr. 011245 / 08 / 02 /2021

Në bazë të nenit 48, pika 1.3 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 05.02.2021, mori:

VENDIM

Dr.sc. Bashkim Dalipi, zgjedhet në thirrjen akademike **Profesor i Asociuar** për lëndët: Bazat e shkencave natyrore me metodologji, Edukim mjedisor, Fëmijët dhe mësimi në natyrë (Fillor dhe Parashkollor) me plotësim norme në Fakultetin e Shkencave Aplikative, lëndët Fizika dhe Projekt laboratorik i fizikës në Fakultetin e Edukimit në Universitetin "Kadri Zeka" Gjilan.

Emërimi është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 153 dhe 156 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Universitetit.

Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhurat personale.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

Arsyetim

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan ka shpallur konkurs për zgjedhjen/rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Bazat e shkencave natyrore me metodologji, Edukim mjedisor, Fëmijët dhe mësimi në natyrë (Fillor dhe Parashkollor) me plotësim norme në Fakultetin e Shkencave Aplikative, lëndët Fizika dhe Projekt laboratorik i fizikës në Fakultetin e Edukimit në Universitetin "Kadri Zeka" Gjilan.

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Prof.Ass.Dr. Bashkim Dalipi, i plotëson kushtet për t'u zgjedh në thirrjen akademike Profesor i Asociuar për lëndët e sipërpërmendura. Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve, vendosi që Dr.sc. Bashkim Dalipi, të zgjedhet në thirrjen akademike Profesor i Asociuar.


Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtrësia të Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit




Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, rektor
Kryesues i Senatit